



Në bazë të nenit 12.2 pika d), nenit 40 paragrafi 2 pika d) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së”, nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 paragrafi 3 pika g) të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e tretë të rregullt, e mbajtur më datën 29.03.2024, merr këtë:

V E N D I M Nr.19/2024/KG

për miratimin e Raportit vjetor të punës dhe realizimit të planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2023

Neni 1

Miratohet Raporti vjetor i punës dhe realizimit të planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2023.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti vjetor nr.1320/24 i datës 15.03.2024 i punës dhe realizimit të planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2023.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

